



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura III

Seancë plenare e Kuvendit të Kosovës

P- 006

Prishtinë, më 19 shkurt 2008

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
19 SHKURT 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari i përshëndeti deputetët dhe iu uroi punë të mbarë në seancën e parë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Përshëndetje të veçanta ai u drejtoi qytetarëve të Republikës së Kosovës brenda dhe jashtë vendit për manifestime dinjitoze që organizuan për Ditën e Pavarësisë e të sovranitetit të shtetit të Kosovës.

Ai gjithashtu i falënderoi edhe të gjitha mediat vendore e ndërkombëtare për informim korrekt të opinionit vendor e ndërkombëtar.

Kryetari gjithashtu përshëndeti edhe qytetarët serbë të Kosovës dhe ju premtoi atyre se akti i shpalljes se pavarësisë e të sovranitetit të Republikës së Kosovës, nuk i dëmton në asnjë mënyrë interesat e asnjë komuniteti të Kosovës. Ai gjithashtu i siguroi se mbroja e lirisë individuale e kombëtare, të drejtat e njeriut dhe e drejta e pronës, e lëvizjes së lirë të qytetarëve të Kosovës, është garantuar në mënyrë të qartë në Deklaratën për Pavarësisë e Kosovës, në dokumentin gjithëpërfshirës të Ahtisarit, në Projekt Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe në ligjet e tjera.

Kryetari shprehu mirënjohje të veçantë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Presidentin Bush, për Bashkimin Evropian, për Francën dhe Presidentin Sarkozy, për Britaninë e Madhe dhe Kryeministrin Braun, për Belgjikën, Izraelin, Turqinë, Shqipërinë, Afganistanin dhe të gjitha vendet e tjera që e njohën pavarësinë dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës dhe të tjera që po përgatiten ta njohin.

Ai në fund apeloj për njohje të përsheptuar të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës, nga të gjitha vendet e Bashkimit Evropian dhe nga të gjithë anëtarët e OKB-së, duke theksuar se një njohje e tillë do t'i ketë dy anë pozitive.

1. Njohja e përmbyll një proces të natyrshëm, e korrigjon një padrejtësi historike, perspektivës i hap të gjitha rrugët e zhvillimit demokratik dhe ekonomik.
2. E ndihmon politikën serbe që të shkëputet nga e kaluara jodemokratike dhe do të përsheptojë në Serbi sundimin e demokracisë dhe të partneritetit reciprok.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 109 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me të, sipas procedurës së veçantë të datës 15 shkurt 2008, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi njëzëri miratoi këtë

R e n d t ë d i t ë s:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme;
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për privilegje dhe imunitete diplomatike;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shtetësinë;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për policinë;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin policor;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin e simboleve shtetërore;
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat e veçanta të mbrojtura;
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vetëqeverisjen lokale, dhe
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kufijtë administrativë të komunave.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme

Kryetari i informoi të pranishmit se ky projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Kryetari e ftoi Kryeministrin e Kosovës që në emër të Qeverisë, ta prezantojë Projektligjin.

Kryeministri **Hashim Thaçi**, përshëndeti të pranishmit dhe shprehu kënaqësi për paraqitjen e projektligjeve të para për implementimin e dokumentit gjithëpërfshirës për Kosovën e pavarur, sovranë dhe demokratike.

Ai në vazhdim tha se, në këto momente historike të themelimit të shtetit të Kosovës, Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme i hartuar nga Zyra e Kryeministrit, themelon një institucion dhe autoritet të ri të Republikës së Kosovës për realizimin e punëve të jashtme, promovimin ndërkombëtar të interesave politike dhe ekonomike të Kosovës, si dhe zhvillimin e marrëdhënieve të mira me shtetet tjera.

Ky projektligj, është risi në vete dhe i domosdoshëm për rregullimin e kësaj sfere kaq të rëndësishme, sepse rregullon autoritetin dhe kompetencat e institucioneve të Kosovës lidhur me punët e jashtme dhe mbështet interesat politike dhe ekonomike të Kosovës.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për privilegje dhe imunitete diplomatike

Kryetari i informoi të pranishmit se ky projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin i tij, në parim.

Kryetari e ftoi Kryeministrin e Kosovës që në emër të Qeverisë, ta prezantojë Projektligjin.

Kryeministri **Hashim Thaçi**, e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, duke thënë se ky ligj është një prej ligjeve me prioritet, i cili duhet të kalojë gjatë periudhës së paraparë transitore në Kosovë.

Në vazhdim, Kryeministri Thaçi arsyetoi: qëllimin, objektivat dhe materien që e rregullon ky projektligj. Ai theksoi gjithashtu se ky projektligj është hartuar mbi bazat e legjislacionit ndërkombëtar dhe atij Evropian.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shtetësinë

Kryetari i informoi të pranishmit se ky projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Kryetari ftoi ministrin Zenun Pajaziti që në emër të Qeverisë, ta prezantojë Projektligjin.

Ministri i Punëve të Brendshme, **Zenun Pajaziti**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Pajziti** arsyetoi: qëllimin, objektivat dhe materien që e rregullon Projektligji për shtetësinë, i radhitur në 6 kapituj me gjithsej 32 nene. Ai theksoi se ky projektligj është në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e BE-së, dhe se për implementimin e këtij ligji nuk kërkohen mjete buxhetore shtesë. Ky ligj krijon të hyra që priten të realizohen nga taksat administrative për dhënien edhe humbjen e shtetësisë.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për policinë

Kryetari i informoi të pranishmit se ky projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Kryetari ftoi ministrin Zenun Pajaziti që në emër të Qeverisë, të prezantojë Projektligjin.

Ministri i Punëve të Brendshme, **Zenun Pajaziti**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Pajaziti** arsyetoi: qëllimin, objektivat dhe materien që e rregullon Projektligji për policinë, i radhitur në 8 kapituj me 75 nene. Ai shtoi se ky Projektligj është në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e BE-së, ndërsa implikimet buxhetore vlerësohet të jenë, përafërsisht, prej 33 milion euro për periudhën prej vitit 2008 – 2010.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin Policor

Kryetari i informoi të pranishmit se ky projektligj iu është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Kryetari e ftoi ministrin Zenun Pajaziti që në emër të Qeverisë, të prezantojë Projektligjin.

Ministri i Punëve të Brendshme, **Zenun Pajaziti**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Pajaziti** arsyetoi: qëllimin, objektivat dhe materien që e rregullon Projektligji për Inspektoratin Policor, i radhitur në 12 kapituj me gjithsej 36 nene. Ai theksoi se ky projektligj është në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e BE-së.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit

Kryetari i informoi të pranishmit se ky projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Kryetari e ftoi ministrin Zenun Pajaziti që në emër të Qeverisë, të prezantojë Projektligjin.

Ministri i Punëve të Brendshme, **Zenun Pajaziti**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Pajaziti** arsyetoi: qëllimin, objektivat dhe materien që e rregullon Projektligji për dokumentet e udhëtimit, i radhitur në 9 kapituj me 40 nene. Ai theksoi se ky projektligj është në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e BE-së.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin e simboleve shtetërore

Kryetari i informoi të pranishmit se ky projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe në bazë vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Kryetari e ftoi ministrin Arsim Bajramin që në emër të Qeverisë, ta prezantojë Projektligjin.

Ministri i Shërbimeve Publike, **Arsim Bajrami**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Bajrami** arsyetoi: qëllimin, objektivat dhe materien që e rregullon Projektligji për simbolet shtetërore, i radhitur në 5 pjesë dhe ka gjithsej 19 nene .

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat e veçanta të mbrojtura

Kryetari i informoi të pranishmit se ky projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe në bazë vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Kryetari e ftoi ministrin Mahir Yagcilar, që në emër të Qeverisë, ta prezantojë Projektligjin.

Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, **Mahir Yagcilar**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri Yagcilar arsyetoi: qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për zonat e veçanta të mbrojtura , i cili është në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e BE-së.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vetëqeverisjen lokale

Kryetari i informoi të pranishmit se ky projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe në bazë vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Kryetari e ftoi ministrin Sadri Ferati, që në emër të Qeverisë, të prezantojë Projektligjin.

Ministri i Pushteti Lokal , **Sadri Ferati** , në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri Ferati arsyetoi: qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për vetëqeverisjen lokale, i cili është në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e BE-së.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kufijtë administrativ komunal

Kryetari i informoi të pranishmit se ky projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe në bazë vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Kryetari e ftoi ministrin Sadri Ferati, që në emër të Qeverisë, të prezantojë Projektligjin.

Ministri i Pushteti Lokal , **Sadri Ferati** , në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri Ferati arsyetoi: qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për administrimin komunal, si dhe mënyrën e implementimit të tij. Ai theksoi se ky Projektligj është në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e BE-së.

Kryetari, pas prezantimit të të gjitha projektligjeve hapi debatin.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentare të PDK-së, tha se në parim ky grup i përkrah këto ligje për t'u shqyrtuar ose për t'u lexuar në leximin e dytë. Ai tha se ky grup do të bëjë propozim amendamentet sa u përket këtyre Projektligjeve: Projektligjin për zonat e veçanta të mbrojtura, Projektligjin për vetëqeverisjen lokale dhe Projektligjin për kufijtë administrativ komunal.

Eqrem Kryeziu, në emër të Grupi Parlamentar të LDK-së, deklaroi se e mbështetësin në parim miratimin e këtyre projektligjeve, natyrisht duke e ruajtur të drejtën për t'i dhënë vërejtjet eventuale në Komisionin ad-hoc.

Rita Hajzeraj, në emër të Grupi Parlamentar të AKR-së, deklaroi se e mbështetësin në parim miratimin e këtyre projektligjeve, ndërsa sugjerimet, vërejtjet dhe propozimet e caktuara për këtë etapë të procedurës, do t'i japin në Komisioni Ad-hoc.

Ardian Gjini, në emër të Grupi Parlamentar të AAK-së, deklaroi se e mbështetësin miratimin në parim të këtyre projektligjeve, ndërsa kontributin e tyre ky grup do ta jap në Komisionin Ad-hoc .

Lulzim Zeneli, në emër të Grupi Parlamentar të LDD-së, tha se e mbështetësin në parim miratimin këtyre projektligjeve. Ai pati vërejtje sa i përket terminologjisë e cila është përdorur në një pjesë të madhe të këtyre projektligjeve, pastaj lidhur me statusin e shumë monumenteve si dhe emërtimin e vendbanimeve të cilat nuk përkojnë me realitetin.

Enis Kervan, në emër të Grupi Parlamentar 7+ , deklaroi se e mbështetësin në parim miratimin e këtyre projektligjeve, ndërsa sugjerimet, vërejtjet dhe propozimet e caktuara për këtë etapë të procedurës, do t'i adresojmë te Komisioni Ad-hoc.

Kryetari i njoftoi deputetët se në bazë të vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008, tani do të bëhet miratimi në parim i këtyre 10 ligjeve të prezantuara gjatë kësaj seance.

Kryetari e hodhi në votim miratimin, në parim, të 10 projektligjeve. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----84

Kundër-----2

Abstenuan ----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash,

V E N D O S I

I. Miratohen, në parim, këto projektligje:

1. Projektligji për Minisrinë e Punëve të Jashtme
2. Projektligji për privilegje dhe imunitete diplomatike,
3. Projektligji për shtetësinë,
4. Projektligji për policinë.
5. Projektligji për Inspektoratin policor,
6. Projektligji për dokumentet e udhëtimit,
7. Projektligji për përdorimin e simboleve të shtetit,
8. Projektligji për zona të veçanta të mbrojtura,
9. Projektligji për vetëqeverisjen lokale dhe
10. Projektligji për kufijt administrativ të komunave.

II. Ngarkohet Komisioni ad-hoc që t'i shqyrtojë këto projektligje dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 16:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Njësia për Çështje Plenare dhe Procedurale